

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI****VENDIM****Nr. 11, Datë 29.01.2024****MBI****ZGJATJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZE” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 130/3 prot., datë 22.01.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “DRINI BULQIZE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417 prot., datë 17.11.2023, ka paraqitur kërkesën për pajisje me licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 354, datë 01.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 02.12.2023 dhe 04.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2417/5 prot., datë 07.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit, duke evidentuar dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresat me nr. 2417/6 prot. dhe nr. 2416/3 prot., datë 11.12.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet e gjithashtu të sqarohet një pjesë e këtij dokumentacioni me shoqërinë, ndaj me shkresën nr. 2417/8 prot., datë 19.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s.
- Nisur nga nevoja për të pasur kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit shtesë dhe/ose shkëmbimin e një korrespondence të mëtejshme me shoqërinë, u propozua zgjatja e afatit të trajtimit të kësaj praktike, e në vijim bordi i ERE-s me vendimin nr. 381, datë

28.12.2023 vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë.

- Pas depozitimit të dokumentacionit shtesë të aplikimit dhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 17.01.2024, nga shoqëria u mor angazhimi për të depozituar në ERE të gjithë informacionin/dokumentacionin e munguar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/2 prot., datë 18.10.2023, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se mbetet ende dokumentacion i paplotësuar dhe po ashtu ka lindur nevoja që vetë ERE t'i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (në lidhje me qëndrimin/miratimin e saj për ndryshimin e vlerës së investimit dhe zgjatjen e afatit të ndërtimit të hidrocentralit), Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (në lidhje me vlefshmërinë e VNM-së paraprake) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (për statusin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor).
- Sa më lartë dhe në mbështetje të nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 14, pika 3 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, me qëllim saktësim e dokumentacionit financiar, vlerësohet e arsyeshme zgjatja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s në lidhje kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRINI BULQIZE” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**